

1 E Mërkurë, 19 maj 2021  
2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]  
3 [Seancë e hapur]  
4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]  
5 --- Fillon në orën 11.02

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjesi dhe mirë se  
7 keni ardhur të gjithë ju që jeni të pranishëm në sallë dhe ju  
8 që na ndiqni në distancë.

9 Zonja sekretare, mund të thërrisni çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
11 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
12 Thaçit, Kadri Veselit dhe të tjerëve.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
14 sekretare.

15 Tani do të doja që t'u kërkoja palëve dhe pjesëmarrësve  
16 që të prezantoheshin, duke filluar me Zyrën e Prokurorisë së  
17 Specializuar.

18 Zonja prokurore, fjala për ju.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëmëngjesi, i nderuar Gjykatës,  
20 për Zyrën e Prokurorit të Specializuar të pranishëm në sallë  
21 janë Alan Tieger, Prokuror i Lartë, David Harbach, prokuror,  
22 Nathan Quick, drejtues i asociuar i skuadrës dhe Marlene Yahya  
23 Haage, nëpunëse ligjore e nxjerrjes së dokumenteve dhe unë jam  
24 Clare Lawson dhe jam analiste e lartë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja

1 prokurore.

2 Tani, më lejoni t'i jap fjalën Mbrojtjes.

3 Ju lutem, avokatëve mbrojtës të prezantohen vetë dhe  
4 ekipet e tyre, duke filluar me z. Prosper.

5 Z. PROSPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]

6 Mirëmëngjesi. Unë jam z. Prosper, jam në emër -- përfaqësoj  
7 këtu z. Thaçi dhe kam këtu edhe z. Pallaka si bashkëavokat në  
8 këtë çështje.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

10 Z. Emmerson fjala për ju.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]

12 Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Mirëmëngjesi të gjithëve të  
13 pranishëm në sallë dhe që na ndiqni në distancë. Unë  
14 përfaqësoj z. Veseli së bashku me bashkëmbrojtësin Nick  
15 Kaufman.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

17 Z. Young, fjala për juve.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

19 Unë, jam David Young dhe përfaqësojë Rexhep Selimin sot.

20 Faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

22 Znj. Alagendra fjala për ju.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]

24 Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës, unë jam znj. Alagendra dhe  
25 jam mbrojtësja për z. Jakup Krasiqi, dhe kam me vete

1 gjithashtu edhe z. Ellis dhe Mentor Beqirin.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për procesverbal, vërej se  
3 që z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi nuk janë  
4 fizikisht të pranishëm në sallën e gjyqit, por e ndjekin këtë  
5 seancë gjyqësore përmes videokonferencës.

6 Tani, më lejoni t'i drejtohem mbrojtësit për viktimat, z.  
7 Laws, ju lutem.

8 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë jam Simon  
9 Laws, jam avokat i caktuar kryesisht për viktimat për këtë  
10 çështje.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Laws.

12 Tani, fjala për Zyrën Administratore. Z. Roche, fjala për  
13 juve.

14 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit. Unë jam z. Roche, jam  
15 përfaqësuesi i Zyrës së Administrimit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roche.

17 Dhe për procesverbal, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatësi  
18 i Procedurës Paraprake për këtë çështje.

19 Përpara se sa të vijojmë rendin e ditës sot, do të doja  
20 t'u kërkoja dhe kujtoja palëve që, në qoftë se gjatë ndjekjes  
21 së kësaj videokonference, palët hasen në probleme teknike, ju  
22 lutem, më informoni mua dhe sekretaren duke ngritur dorën.

23 Tani, le të kalojmë pak tek historiku i fundit procedural  
24 i kësaj çështjeje.

25 Më 14 maj 2021, unë kam planifikuar, kam nxjerrë urdhrin

1 për caktimin e seancës së katërt për këtë çështje. U kam  
2 kërkuar palëve që të japin parashkrime me shkrim lidhur me  
3 këtë çështje: nxjerrjen e informacioneve; kundërshtimin e  
4 mbrojtjes sa i takon pranueshmërisë së provave të mbështetura  
5 në rregullin 102; gjendjen e hetimeve të ZPS-së; gjendjen e  
6 hetimeve nga Mbrojtja; pikat e marrëveshjes për pikat e ligjit  
7 dhe faktit; datën për konferencën e ardhshme për ecurinë e  
8 çështjes; si dhe çështje të tjera të cilat dëshirojnë palët të  
9 ngrenë.

10 Të martën, më 18 maj, ZPS-ja, Mbrojtja për z. Veseli dhe  
11 Mbrojtja për z. Krasniqin, parashtruan konstatimet e tyre me  
12 shkrim.

13 Dua t'i falënderojë palët për parashtrimet e bëra.

14 Qëllimi i seancës sot është që të rishikojmë ecurinë e  
15 çështjes dhe të diskutojmë së bashku temat të cilat sapo i  
16 përmenda. Dua t'i ftojë palët që të përfaqësojnë pikëpamjet e  
17 tyre në mënyrë koncize lidhur me secilin prej zërave.

18 Dua t'i kujtoj palët, që të njoftojnë paraprakisht në  
19 qoftë se parashtrimet e tyre kërkonin nxjerrje të  
20 informacionit konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë  
21 private ose me dyer të mbyllura.

22 Përpara sesa të fillojmë me programin për sot, do të doja  
23 që të falënderoja palët për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet  
24 për mocionet paraprake. I informoj palët që unë do të nxjerrë  
25 një urdhër me gojë në fund të konferencës për ecurinë e

1 çështjes lidhur me afatet kohore për të nxjerrë vendimet e mia  
2 për mocionet paraprahe të depozituara nga Mbrojtja.

3 Dhe përpara sesa të kalojmë me rendin e ditës, që është  
4 përcaktuar për këtë konferencë për ecurinë e çështjes, do të  
5 doja që të diskutonim shkurtimisht çështjen e përkthimeve.

6 Vërej se Mbrojtja për z. Krasniqi, ngrenë çështjen e  
7 përkthimeve. Në veçanti, çështjen e përkthimeve që kanë të  
8 bëjnë me përmbledhjen e detajuar të parashikuar në rregullën  
9 86(3)(b) dhe përkthimet e depozitimeve të parashtruara, të  
10 cilat kanë kërkuar përparësi ose janë përcaktuar si me  
11 përparësi.

12 Së pari, do të doja që të dëgjoja nga Zyra e  
13 Administrimit, lidhur me progresin e bërë për përkthimin e  
14 zërave të përmendur më sipër. Vërej se, në konferencën për  
15 ecurinë e çështjes të organizuar më datë 16 shkurt 2021, Zyra  
16 e Administrimit tha se mund të vinte në dispozicion 150 faqet  
17 e para të parashikuar në rregullën 86 (3)(b), të rishikuara  
18 dhe përkthyer jo më vonë se data 20 prill 2021, dhe se do të  
19 ishte në gjendje të jepte dokumentacionin e plotë deri në fund  
20 të majit.

21 Z. Roche, fjala për juve për të na informuar sa i takon  
22 afatit kohor për përkthimet e cituara më sipër.

23 Z.ROCHE: [Përkthim] Faleminderit shumë, i nderuar  
24 Gjykatës.

25 Sa i takon përkthimeve, ne po bëjmë progres. Sa i takon

1 qëllimit ose dëshirës për të dorëzuar 150 faqe deri më datë 20  
2 prill, kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të prioritizimit të  
3 çështjeve të tjera, të cilat na kanë marrë një pjesë të  
4 burimeve të Zyrës së Shërbimeve të Gjyqësore dhe ndërkohë, që  
5 ne po punojmë për përfundimin e tij.

6 Sa i takon përfundimit të përkthimit në fjalë, mbetet  
7 ende data 31 maj. Tani jemi në procesin e fundit të  
8 përfundimit të përkthimit dhe të rishikimit dhe do t'jua vëmë  
9 atë në dispozicion deri më datë 31 maj.

10 Sa i takon dokumenteve të tjera, të cilat janë përcaktuar  
11 me përparësi për përkthimin, progresi është shumë pozitiv dhe  
12 do të kemi disa prej këtyre materialeve gati për shpërndarje,  
13 për palët deri në mes të qershorit.

14 Pra, kemi gjithashtu edhe një vendim, që është vendimi  
15 për konfirmimin që është gati 300 faqe dhe ai nuk do të jetë  
16 gati në këtë kohë por ndërkohë dokumentet të cilat janë  
17 përcaktuar si përparësi do të jenë gati diku nga mesi i  
18 qershorit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roche. Ju  
20 lutem, për të ardhmen, do të doja që ftoja Zyrën e  
21 Administrimit që të na njoftonte në qoftë se nuk mund të  
22 përmbushen afatet kohore të cilat na janë dhënë më parë.

23 Tani do të doja që t'u jepja fjalën Mbrojtjes, që të  
24 shpreheshin lidhur me çështjen e përkthimeve duke filluar me  
25 z. Prosper.

1 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
2 i nderuar Gjykatës, nuk kam komente.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Emerson.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar  
6 Gjykatës, do të doja që t'i jepja fjalën z. Kaufman për t'u  
7 shprehur lidhur me këtë çështje.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kaufman, fjala për ju.

9 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Gjykatës,  
10 nuk kam asnjë koment lidhur me këtë pikë, për momentin.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Viojtmë më tej.

12 Z. Young.

13 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam  
14 komente në këtë fazë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

16 Znj. Alagendra.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes]  
18 Faleminderit për përditësimin. Nuk kemi komente për momentin.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se  
20 Prokuroria ka ndonjë koment lidhur me këtë pikë? Jo. Atëherë  
21 vijojmë me pikën e parë në rendin e ditës për sot, nxjerrja e  
22 informacioneve.

23 Së pari, do të doja të dëgjojë Prokurorinë lidhur me  
24 progresin e bërë për nxjerrjen e materialit provues. Në  
25 veçanti dua të di, në qoftë se ZPS-ja ka përfunduar nxjerrjen

1 e materialeve të mbetura që i janë treguar secilit prej të  
2 akuzuarve gjatë intervistave përkatëse me ZPS-në.

3 Së dyti, çfarë progresi është bërë lidhur me  
4 nxjerrjen e materialit të paraparë në rregullën 102(1)(b) nga  
5 ZPS-ja deri në afatin kohor të 23 korrikut 2021 dhe në  
6 veçanti, sa shumë nga ky material mbetet ende për të nxjerrë  
7 dhe kur parashikon ZPS-ja që nxjerrë kërkesa për masa të  
8 mëtejshme mbrojtëse mbështetur në rregullën 102(1)(b) deri më  
9 4 qershor 2021; nëse palët kanë pasur vështirësi për sa i  
10 takon përdorimit të kategorizimit specifik të materialit të  
11 parashikuar në rregullën 102(1)(b) në sistemin Legal Workflow  
12 siç është urdhëruar në vendimin mbështetur në rregullën  
13 109(c) (sipas përkthimit); në qoftë se ZPS-ja është në rrugën e  
14 duhur për të ofruar për Mbrojtjen njoftim të detajuar për  
15 provat të cilat bien në rregullin 102(3) deri të premtën datë  
16 25 qershor 2021; në qoftë se mbeten prova shfajësuese nën  
17 ruajtjen e ZPS-së, nën kontrollin apo njohurinë e saj dhe në  
18 qoftë se nevojiten masa mbrojtëse për to; dhe në qoftë se ZPS-  
19 ja po haset me -- ose parashikon vështirësi lidhur me procesin  
20 e nxjerrjes së materialeve, në veçanti, lidhur me materialin  
21 nën rregullën 107 dhe në qoftë se aplikimi në përputhje me  
22 këtë rregull është i menjëhershëm.

23 Zonja Prokurore, fjala për ju.

24 ZNJ. YAHYA HAAGE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
25 Gjykatës. Faleminderit dhe mirëmëngjesi juve dhe të gjithëve



1 të pranishmëve në sallë. Do të doja të jepja një përditësim të  
2 progresit të nxjerrjes së dokumenteve.

3 Siç përmendet në parashtrimet tona, të gjitha dokumentet  
4 e mbetura dhe që u janë treguar të akuzuarve, janë nxjerrë në  
5 prill. Pra, janë më datë 1 prill të 2021-t. Dhe përderisa, në  
6 konferencën e fundit të ecurisë së çështjes mbështetur në  
7 fashikullin e rregullës 102(1)(b), ky material është nxjerrë  
8 deri më 28 prill. Janë nxjerrë, gjithashtu, edhe masa të tjera  
9 mbrojtëse.

10 Ne parashikojmë që të ketë edhe masa të tjera mbrojtëse  
11 të kërkuara për t'u depozituar në lidhje me rregullin  
12 102(1)(b). Të gjithë materialet që janë nxjerrë deri tani  
13 mbështetur në rregullin 101(b) (siç u përkthye) janë përditësuar  
14 për të reflektuar nën kategoritë shtesë në varësi të  
15 kategori[së] -- të vendimit për kategorizimin. Siç iu përmend  
16 edhe në parashtrimet tona, pra, ka burime të domethënëse të  
17 Zyrës së Administrimit të ZPS-së të cilat janë përdorur për të  
18 bërë funksionale të gjithë materialet e nevojshme.

19 Pra, ne do të reflektojmë nën kategoritë, mbështetur në  
20 parashikimet e rregullit 102(b) (siç u përkthye) edhe do të  
21 përditësojmë kategoritë përkatëse. Do të vazhdojmë që të  
22 punojmë me Zyrën e Administrimit për zgjedhjen e çështjeve  
23 teknike të cilat do të lehtësojnë edhe ritmin në të cilin ne  
24 do të nxjerrim paketat e informacionit.

25 Po ashtu është bërë progres i mirë, sa i takon

1 përgatitjes për njoftimin e rregullit 102(3). Megjithatë  
2 përfundimi i saj, për arsye të cilat i kemi përmendur në  
3 parashtrimet e mëparshme, do të varen deri në një masë të  
4 caktuar te progresi i të gjithë nxjerrjes.

5 Po ashtu, ne po vijojmë me rishikimin e materialit  
6 potencial shfajësues. Kohët e fundit kemi bërë një kërkesë për  
7 masë mbrojtëse për sa i takon një numri të vogël dokumentesh  
8 që kanë të bëjnë me rishikimin shfajësues.

9 Në këtë pikë kohe, nuk kemi kërkesa -- nuk kemi  
10 parashikimin për kërkesa të mëtejshme mbrojtëse, për këto  
11 materiale. Megjithatë, ne do të vazhdojmë që të nxjerrim apo  
12 të kërkojmë masa mbrojtëse sipas nevojës në lidhje me  
13 materialin shfajësues potencial.

14 Lidhur me materialin që ka të bëjë me rregullën 107, ne  
15 jemi në diskutime të vazhdueshme me shumë organizata në mënyrë  
16 që të mund të nxjerrim këtë informacion. Siç është parashikuar  
17 dhe më parë, neve sërish jemi në qëndrimin që mund të presim  
18 kërkesa të caktuara në përputhje me rregullin 107, të cilat  
19 mendohen si të nevojshme për përfundimin e diskutimeve. Jemi  
20 të ndërgjegjshëm, të vetëdijshtë për kohën dhe kemi siguruar  
21 që organizatat përkatëse janë të njoftuara për afatet kohore  
22 që duhen respektuar dhe do t'i bëjmë këto kërkesa sapo të kemi  
23 mundësi që t'i bëjmë ato.

24 Ne, jemi rreth dy muaj larg nga data 23 korrik, që është  
25 data e përcaktuar për nxjerrjen mbi bazën e rregullës 101(b)

1 (siç u përkthye) dhe ne po vlerësojmë kohën dhe burimet që  
2 duhen për secilën prej detyrave dhe po e masim atë lidhur me  
3 prodhimin apo lidhur me rezultatin e punës që duhet të bëjmë.  
4 Kjo do ta bëjë të mundur që të bëjmë rregullime dhe përshtatje  
5 kur është e nevojshme, por për faktin që ne jemi në mes të  
6 këtij ushtrimi ose të kësaj pune, sot, nuk jam në pozicion që  
7 të jap një vlerësim të kohës që na duhet për këtë gjë.  
8 Megjithatë dua t'ju sigurojë, të sigurojë Dhomën që neve kemi  
9 caktuar burimet maksimale për këtë detyrë.

10 Kemi bërë shumë progres, që është i dukshëm, sa i përket  
11 paketave ose masave mbrojtëse. Ndërkohë që sa i takon  
12 kërkesave, jo shumë punë është e dukshme, po shpresojmë që kjo  
13 punë të bëhet më e dukshme në ditët në vijim. Ne parashikojmë  
14 që një fashikull i mëtejshëm i mbështetur në rregullën  
15 102(1)(b), që nuk kërkon masa mbrojtëse, të mund të nxirret në  
16 javët në vijim.

17 Po ashtu, është bërë progres i mirë për të lidhur provat  
18 të cilat i referohen deklaratave të dëshmitarëve sipas  
19 kërkesës së Mbrojtjes. Kur është e mundur, ne synojmë që të  
20 nxjerrim paketa të plota të dëshmitarëve por, në qoftë se kjo  
21 nuk është e mundur ne nuk do ta vonojmë nxjerrjen.

22 Siç kemi thënë edhe në parashtrimet tona shpresojmë që të  
23 jemi në një pozicion më të mirë që t'i japim Dhomës dhe sallës  
24 së gjyqit informacion më të mirë në qershor, pra, në  
25 konferencën e radhës për ecurinë e çështjes.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
2 prokurore.

3 Përpara sesa t'i jap fjalën Mbrojtjes, dua të them që sa  
4 i takon rregullit 102(3), pra, materialit në këtë rregull, e  
5 kuptoj që juve keni bërë progres të mirë por do të [doja të]  
6 dija në qoftë se mendoni se do të respektoni këtë afat kohor  
7 apo parashikoni që të bëni një kërkesë për zgjatjen e këtij  
8 afati?

9 ZNJ. YAHYA HAAGE: [Përkthim] Është bërë progres i mirë  
10 por për deri sa ne jemi aktualisht në proces të vlerësimit të  
11 disa çështjeve dhe disa burimeve, ne duhet që të presim që të  
12 përfundojë kjo pjesë e procesit dhe pastaj të bëjmë një  
13 vlerësim në qoftë se do na duhet më shumë kohë apo jo.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, në qoftë se ju kuptova  
15 drejtë, ende e keni si objektiv që të kërkonit dhe të plotësonit  
16 këtë afat kohor por nuk mund të thoni me siguri në qoftë se  
17 mund ta plotësoni atë sot, apo jo?

18 ZNJ. YAHA HAAGE: [Përkthim] Po, është e drejtë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë. Atëherë, më lejoni që  
20 t'ua jap fjalën mbrojtjes për çështjen e nxjerrjes.

21 Z. Prosper, fjala për ju.

22 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
23 i nderuar.

24 Siç mund ta imagjinoni, neve po sisim informacionin,  
25 materialin që na është ofruar nga Zyra e Prokurorisë dhe siç u

1 theksua dhe nga Prokuroria, informacioni nuk është i plotë.  
2 Pra, kemi ende informacion që mungon. Po shohim që ka prova  
3 materiale të cilat janë përmendur në dokumente ose deklarata  
4 të ndryshme të cilat nuk na janë vënë në dispozicion. Pra, ne  
5 ende po mundohemi që të përpunojmë dhe të analizojmë  
6 informacionin por besojmë që duhet nxjerrë më shumë  
7 informacion.

8 Pra, ca informacion që na është vënë në dispozicion është  
9 i një cilësie shumë të keqe dhe i palexueshëm. Kështu që,  
10 aktualisht, ne po hartojmë një tabelë dhe do t'i drejtohem më  
11 vonë Prokurorisë dhe të shohim nëse mund ta zgjidhim këtë  
12 çështje apo jo. Megjithatë, me siguri mund të them për  
13 momentin që informacioni, dokumentacioni që kemi në  
14 dispozicion nuk është i plotë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

16 Z. Emmerson apo z. Kaufman? Nuk e di kush do ta marrë  
17 fjalën. Z. Emmerson.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Përsëri ia  
19 jap fjalën z. Kaufman në lidhje me çështjet proceduriale.

20 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
21 i nderuar Gjykatës.

22 Në lidhje me këtë çështje, dua që të shikoni paragrafin 2  
23 të parashtrimit që kemi bërë dje, i cili është përfshirë, -  
24 desha ta përmend për procesverbalin - dhe mund shtojë që është  
25 thelbësore të kemi dosjen paraprake dhe nuk ka zëvendësues për

1 të.

2 Dhe puna me Legal Workflow është shumë e vështirë dhe  
3 harxhon shumë kohë.

4 Unë kam edhe parashtime më të gjata, në lidhje me  
5 çështje që lidhen me rregullën 107. Unë i kam përmendur ato  
6 edhe në konferencën për ecurinë e çështjes në fund të  
7 dhjetorit. Nuk e di a doni t'i përsëris?

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mund t'i dëgjojë tani  
9 parashtimet tuaja.

10 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç e kemi  
11 përmendur në parashtimin 315, ne kemi bërë -- kemi komunikuar  
12 me Prokurorinë në lidhje me ruajtjen e disa meta të dhënave të  
13 cilat kanë të bëjnë me konfidencialitetet por faktikisht  
14 Prokuroria ka insistuar që diskutimet -- po, duhet të  
15 vazhdojnë, kemi thënë ne dhe masat kundërbalancuese ende nuk  
16 janë përfunduar.

17 Duket se nuk është bërë asnjë përparim nga Prokuroria, në  
18 kryerjen e detyrave të saj për të plotësuar detyrat e veta në  
19 lidhje me materialet bazë për provat shfajësuese dhe që t'i  
20 jepen ato Mbrojtjes në kohën e duhur.

21 Në lidhje me meta të dhënave që kemi kërkuar ato nuk kanë  
22 për qëllim që të fshehin apo të dëmtojnë konfidencialitetin po  
23 e ndihmojnë Mbrojtjen që Mbrojtja të dijë sesa materiale do të  
24 ketë Prokuroria dhe sa do t'i jepen Mbrojtjes.

25 Me lejen tuaj, i nderuar Gjykatës, desha të them edhe

1 disa fjalë për sa i përket përdorimit të rregullës 107, në  
2 mënyrë të ligjshme.

3 Rregulli 107, ka të bëjë me nenin 54 pikë(3)pika (e) e  
4 Statutit të Romës dhe ata që marrin pjesë këtu, në këtë  
5 seancë, si z. Hooper për shembull, e dinë sesa vështirësi dhe  
6 sa probleme paraqet kjo fushë e minuar prokuroriale..

7 Ta themi thjeshtë, ka një tendencë nga shumë prokurorë  
8 dhe hetues që të provojnë dobishmërinë e materialeve të tyre  
9 dhe pas asaj duke mos pasur një fushëpamje të gjerë të tyre,  
10 nuk i japin Mbrojtjes materiale, duke thënë se ato nuk janë të  
11 nxjerrshme.

12 Rregulla 107, nuk lë vend të dyshohet se konkluzioni  
13 paraparak i për një dokument konfidencial është një kusht i  
14 domosdoshëm për marrjen e këtij informacioni. Nuk mund të  
15 veprohet në mënyrë të anasjelltë. Pra, të përmendësh rregullën  
16 107 dhe ta vësh atë si etiketë tek materialet "ex post facto",  
17 kjo nuk është e pranueshme.

18 Duke pasur të gjitha këto parasysh, Mbrojtja i kërkoi  
19 Prokurorisë që t'i japi meta të dhënat për të vlerësuar  
20 materialet që ka Prokuroria në kontrollin e vet. Dhe përgjigja  
21 që i dha Prokuroria, ishte pak a shumë e njëjtë me atë  
22 përgjigje që kanë dhënë në konferencat e tjera për ecurinë e  
23 çështjes. Pra, përgjigja ishte që "për të dhënë shifra të  
24 kuptimshme dhe domethënëse për sasinë e këtyre materialeve do  
25 të varej nga informacioni shfajësues" dhe kjo na shqetëson.

1 Pra në lidhje me këtë që duhet që Prokuroria të plotësojë dhe  
2 të përmbushi detyrimet e veta në lidhje me materialet që duhet  
3 të nxjerrë.

4 Ne ju kërkojmë juve, i nderuar Gjykatës, që t'i jepni  
5 urdhër Prokurorisë që të na japë, sa më shpejtë që të jetë e  
6 mundur, numrin e materialeve që i përkasin rregullës 107;  
7 numrin e organizatave që i japin këto materiale; numrat e ERN-  
8 së, pra, e regjistrimit të provave që lidhen me to; datat kur  
9 janë krijuar ato.

10 Dhe janë pikërisht këto meta të dhëna që kërkon -- që  
11 thotë Prokuroria se nuk mund t'i japi. Dhe nuk është e qartë  
12 nëse, a i ka marrë këto materiale ashtu siç duhet apo jo.

13 Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pyetja që kam unë për ju  
15 është: Metadat që po kërkonit janë të listuara në fund të  
16 parashtrimit tuaj apo jo? Për ato meta të dhëna e keni fjalën?

17 Z. KAUFMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po,  
18 pikërisht ato janë meta të dhënat që kemi kërkuar ne dhe, që  
19 ua kemi komunikuar këtë kërkesë edhe Prokurorisë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E shënova. Faleminderit.

21 I japë -- do t'ia japë fjalën Prokurorisë në fund.

22 Do të vazhdojmë me anëtarët e tjerë të Mbrojtjes, për sa  
23 i përket kësaj pike.

24 Z. Young.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë



1 për të shtuar përveç se ndaj shqetësimin që ka, që përmendi z.  
2 Kaufman.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Znj. Alegendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do t'ia  
6 japë z. Ellis për këtë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

8 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Vetëm një  
9 çështje dua të shtoj, dhe kjo lidhet me shqetësimin tonë për  
10 dokumentet që janë sekuestruar gjatë kontrolleve që janë bërë  
11 në nëntor të vitit të kaluar.

12 Ne nuk na janë dhënë këto dokumente, të cilat janë  
13 sekuestruar dhe për sa i përket materialeve të rregullës  
14 102(1)(b), do të ishte e dobishme për përgatitjen tonë që ta  
15 dinim se kur do të jetë e gatshme Mbrojtja (siç u përkthye) të  
16 na i japi këto dokumente.

17 Por, ajo që është më e rëndësishme për ne dhe më imediate  
18 është, detyrimet sipas rregullës 103, dhe e dimë, që ky  
19 material sipas rregullës 103 duhet të jepet menjëherë. Ne e  
20 kuptojmë, që ekziston nevoja për përkthimin e tyre,  
21 megjithatë, është dhënë kjo kërkesë, është bërë kjo kërkesë që  
22 në nëntor dhe kanë kaluar gjashtë muaj. Prandaj, duam që të na  
23 jepen, të na bëhen të ditura menjëherë këto dokumente,  
24 sidomos, në fakt, ato që janë shfajësuese dhe të na thuhet se  
25 kur do të na jepen materialet e tjera.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

2 Tani do t'i kthehem Prokurorisë.

3 Ju lutem, a mund t'u përgjigjeni dy pikave që ngriti  
4 Mbrojtja.

5 E para, për materialin e rregullës 107 dhe së dyti për  
6 dokumentet që janë marrë gjatë sekuestrimit, gjatë kontrollit  
7 që është bërë në nëntor.

8 Zonja prokurore.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

10 Për sa i përket rregullës 107, Mbrojtja kërkoi konfirmim  
11 se rregulla 107 ka lidhje dhe me materialet që janë marrë në  
12 kushtet -- me kushte konfidencialitetit dhe vetëm për qëllimin  
13 e nxjerrjes së provave të reja. Ky konfirmim ishte në  
14 përgjigjen e Prokurorisë dhe nuk ka ndonjë mungesë qartësie në  
15 lidhje me materialet e rregullës 107.

16 Për sa i përket meta të dhënave dhe ndarjes në kategori  
17 të dokumenteve sipas rregullës 107 dhe kushteve të saj, të  
18 dhënat janë kërkuar për t'i mundësuar Mbrojtjes që të  
19 shqyrtonte materialet e rregullës 107, por mund ta them shumë  
20 thjeshtë që Mbrojtja nuk ka të drejtë t'i marri këto  
21 informacione, po kështu, nuk ka asnjë qëllim legjitim për ta  
22 marrë këtë informacion në këtë fazë të procedurës.

23 Nuk ka të drejtë të marri informacione statistike në  
24 lidhje me provat që ka mbledhur Prokuroria gjatë hetimeve të  
25 saj. Për më tepër kërkesa -- disa nga të dhënat që janë

1 kërkuar nga Mbrojtja do të shkelnin kushtet në të cilat janë  
2 marrë këto materiale p.sh., data e dokumentit, në disa raste  
3 numri ERN. Të gjitha këto, zbulimi i tyre do të shkelte këto  
4 kushte.

5 Prokuroria ka detyrimin që të sigurojë që materialet që  
6 duhet të nxirren në bazë të këtyre rregullave ose duhet të  
7 nxirren ose të vendosen përjashtimet përkatëse. Lidhur me  
8 rregullën 107, Prokuroria po angazhohet në mënyrë aktive me  
9 institucionet përkatëse që i kanë lëshuar këto dokumente për  
10 ne.

11 Siç tha kolegja ime, ne i dimë afatet dhe kemi marrë masa  
12 që edhe institucionet të jenë në dijeni të këtyre afateve.  
13 Edhe ashtu siç e thamë në përgjigjen tonë me e-mail, pra, edhe  
14 sikur do t'i kishim këto dhëna, përsëri nuk mund t'i jepnim  
15 këto shifra në këtë kohë. Kjo është për dy arsye.

16 Sepse Prokuroria po bën shqyrtimin e materialeve të cilat  
17 -- vazhdon të bëjë shqyrtimin e materialeve të cilat do të  
18 nxirren. Dhe arsyeja e dytë është që, duke pasur parasysh  
19 natyrën e përpjekjeve të Prokurorisë në lidhje me materialet e  
20 rregullës 107, kjo situatë është dinamike po ndryshon  
21 vazhdimisht.

22 Dhe pikërisht dje p.sh., kemi marrë shumë materiale, një  
23 paketë me materiale, në lidhje me rregullën 107 që janë  
24 miratime të materialeve, pra, shifrat ndryshojnë vazhdimisht.

25 Siç e kemi thënë në parashkrimin me shkrim, do të bëhen

1 aplikimet ose kërkesat përkatëse sapo të jetë në gjendje  
2 Prokuroria që të përmbushi apo të përfundojë diskutimet e  
3 veta.

4 Për sa i përket pikës së dytë, dhe inventarit të  
5 materialeve të sekuestruara, për sa i përket këtyre  
6 materialeve, siç ishte në rastin edhe të z. Veseli, Prokuroria  
7 ka dhënë edhe inventarët e sendeve apo materialeve të  
8 sekuestruara edhe për zotërinjtë Selimi dhe Krasniqi. Këto  
9 materiale ende po vlerësohen nga Prokuroria për të parë nëse  
10 janë materiale shfajësuese apo jo, apo përmbajnë materiale të  
11 tilla.

12 Siç i kemi njoftuar edhe në diskutimet *inter partes*  
13 Mbrojtjen e Krasniqit, këto materiale sapo të -- materialet që  
14 ende nuk janë bërë të ditura do të listohen në njoftimin e  
15 rregullës 102(3).

16 Shqyrtimi i materialeve për qëllime të nxjerrjes së tyre  
17 po vazhdon edhe Mbrojtja e Krasniqit, e dinë, që ka një --  
18 është një material shumë voluminoz. Pra, janë rreth 160 faqe.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Mesa kuptoj, në lidhje me këtë pikën e fundit, Mbrojtja  
21 do të marrë materialin e nxjerrë, në qoftë se është për  
22 rregullën 103, do t'i marri menjëherë, në qoftë se është për  
23 rregullën 101 pika -- 102(1)(b) do t'i marri deri më 23 qershor  
24 dhe në qoftë se nuk është ndonjë prej këtyre dyjave më 25  
25 qershor. Më falni. 102(1)(b) më datë 23 korrik dhe në qoftë se

1 nuk është ndonjë nga këto të dyja më 25 qershor.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, ashtu është e saktë mbasi të  
3 jenë shqyrtuar këto materiale sipas pikave 102(1)(b) dhe  
4 102(3). Po.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, t'i kthehem pikës  
6 së parë që trajtuat në lidhje me materialin sipas pikës 107,  
7 rregullës 107.

8 Çfarë keni për të thënë për këtë?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Parashtrimet tona do të ishin që  
10 afatet janë përcaktuar në lidhje me të dhe ne nëse do të  
11 mbështetemi në këtë informacion kemi një afat që është caktuar  
12 dhe po punojmë që ta përmbushim, t'i përmbushim detyrimet tona  
13 në bazë të atij afati. Në qoftë se aty do të ketë materiale  
14 shfajësuese do t'i nxjerrim menjëherë sapo të na jepen apo  
15 sapo t'i kemi në dispozicion.

16 Në qoftë se në kohën që po nxjerrim material sipas  
17 rregullës 102, do të na dalin se ka materiale të tjera  
18 shfajësuese që i nënshtrohen rregullës 107, që nuk janë  
19 nxjerrë, do t'i bëjmë kërkesat përkatëse.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja  
21 prokurore.

22 Tani Mbrojtja, keni fjalën.

23 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

24 Për sa i përket që nuk kemi të drejtën t'i kemi meta të  
25 dhënat, kjo është diçka e re. Unë i referohem paragrafit 7 të

1   parashtrimit tonë numër 315 që është futur në procesverbal.

2           Dhe përgjigja e Prokurorisë aty është krejt e qartë.

3           Në qoftë se ata do të mendonim që ne nuk na takon ky  
4   informacion duhet të na kishin thënë menjëherë. Kjo [është]  
5   diçka e re që na del.

6           Për sa i përket shqetësimeve të tona të tjera ne i kemi  
7   përfshirë këto në parashtrimin tonë dhe janë futur në  
8   procesverbal.

9           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kaufman.

10          Atëherë z. Prosper. Dhe pastaj do t'ia jap fjalën z.  
11   Ellis për çështjen e dytë.

12          Z. PROSPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]  
13   Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14          Unë i bashkohem parashtrimit që bëri z. Kaufman. Në  
15   lidhje me këtë çështjen e informacionit në bazë të rregullës  
16   107, unë mendoj se është e rëndësishme të dimë disa gjëra.

17          Unë kam qenë edhe në anën tjetër, në palën që ka bërë  
18   nxjerrjen e informacionit dhe është diçka shumë e thjeshtë siç  
19   tha Prokuroria, dje kanë marrë lejet apo miratimin për  
20   nxjerrjen e disa materialeve, pra, nuk ka arsye që ky  
21   informacion të mos na vijë asnjëherë ne.

22          Por pika kryesore është që të kuptojmë, se çfarë janë  
23   këto agjenci dhe çfarë lloj informacioni është kërkuar prej  
24   tyre dhe arsyeja është kjo, sepse Prokuroria nuk ka monopol  
25   për të angazhuar shtete apo organizata apo institucione të

1 tjera për marrjen e këtij informacioni dhe në qoftë se Trupi  
2 Gjykues do ta bëjë, do ta kryejë këtë çështjeje në mënyrë të  
3 përshpejtuar, atëherë, do të ishte e dobishme që ne t'i kishim  
4 këto informacione, sepse përndryshe do të bëhej dyfishimi. Do  
5 të bëhej duplikimi i përpjekjeve dhe ekipet e mbrojtjes do të  
6 kërkonin që t'u jepej informacion vazhdimisht e vazhdimisht.  
7 Pra, kjo jo vetëm që do t'i vononte procedurat po edhe do të  
8 provonte durimin e këtyre agjencive të cilat bashkëpunojnë.

9 Pra, prandaj edhe na duhet ky informacion. Cilat agjenci  
10 janë kontaktuar dhe çfarë informacion është kërkuar prej tyre?

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

12 Z. Ellis, përpara se të flisni ju, do t'ia jap fjalën  
13 prokurores, në lidhje me çështjen e kontaktimit të agjencive  
14 të ndryshme.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë desha të them që materialet  
16 që janë kërkuar do t'i jepen Mbrojtjes kur të bëhet nxjerrja e  
17 tyre dhe ata do të ta shikojnë vetë se nga cilat agjenci janë  
18 marrë këto informacione dhe do të mund të shmangin duplikimin  
19 e tyre.

20 Dhe, për sa i përket dhënies së identitetit të këtyre  
21 agjencive apo organizatave, gjatë kohës që ne jemi të  
22 angazhuar me ta, do të ishte në shkelje të rregullës 107.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk shoh ndonjë person  
24 tjetër që do të marri fjalën, kështu që i jap fjalën z. Ellis  
25 në lidhje me këtë çështje që sapo diskutuam.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Shumë  
2 shkurtimisht.

3 Atëherë, çfarë do të thotë "menjëherë mbasi t'i  
4 përpunojë" prokuroria këto dokumente do t'ia japi Mbrojtjes?  
5 Ky është një material që Prokuroria e ka pasë për gjashtë muaj  
6 dhe duhet t'i jepet një urgjencë më e madhe kryerjes dhe t'i  
7 jepet më shumë prioritet kryerjes së këtyre procedurave. Ne  
8 jemi duke e prioritarizuar, me qëllim që t'i japim Mbrojtjes  
9 indeksin e gjatë. Është një vëllim shumë i madh materialesh që  
10 krahasuar me materialet e tjera i kemi marrë kohët e fundit  
11 dhe përpunimi i tyre do të thotë, përkthimi dhe sipas rastit  
12 redaktimi i tyre. Kemi shumë punë për të bërë lidhur me  
13 prioritarizimin. Ne po bëjmë maksimumin tonë bashkë me gjithë  
14 materialet e tjera që duhet të nxjerrim.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mora shënim.

16 Nuk shoh që dikush të kërkojë fjalën për këtë temë,  
17 kështu që, po vazhdojë me pikën e dytë të agjendës sonë që ka  
18 të bëjë me kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me materialet dhe  
19 provat e rregullës 102.

20 Po i kërkoj Mbrojtjes së pari, nëse ka ndërmend të  
21 kundërshtojnë pranueshmërinë e materialeve dëshmuese në bazë  
22 të rregullës 102(2) dhe nëse po, në çfarë kohe? Dua të dëgjojë  
23 nga palët lidhur me formatin që do të përdoret për këto  
24 kundërshtime.

25 Kam propozuar formatin e tabelave që të përfshijë



1 informacion lidhur me numrin ERN të dokumentit përkatës  
2 provues; së dyti, numrin e paketës së nxjerrë; së treti  
3 rregullën në të cilën dokumenti përkatës provues është  
4 nxjerrë; dhe së katërti, natyrën e kundërshtimit.

5 Ftoj palët që të më njoftojnë nëse kanë ndonjë koment  
6 lidhur me formatin e propozuar. Fillojmë nga Mbrojtja.

7 Z. Prosper.

8 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
9 i nderuar.

10 Dua ta kuptojë pyetjen lidhur me kundërshtimin që presim  
11 të mos kemi ne.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në këtë fazë, keni ndonjë  
13 koment për formatin që unë propozova? Do të ishte i  
14 përshtatshëm një format i tillë për kundërshtimet e ardhshme?  
15 Dhe tani që flasim a jeni në gjendja të na jepni një afat  
16 kohor lidhur me kundërshtimet apo jo?

17 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Në të dy  
18 çështjet nuk jemi në gjendje të përgjigjemi në këtë moment,  
19 kryesisht, sepse është vështirë të kundërshtojmë për çështje  
20 pranueshmërie kur nuk e kemi parë të gjithë paketën në  
21 tërësinë e vet. Së pari, duhet të kuptojmë se si ky  
22 informacion që marrim përputhet që të kemi një ide të  
23 përgjithshme për të dalë me një përfundim lidhur me çfarë mund  
24 të kundërshtohet për pranueshmëri dhe si duhet të  
25 kundërshtohet.

1 Dhe kjo na sjell tek pamja më e madhe, e përgjithshme por  
2 nuk dua të testoj durimin tuaj. Kur vjen puna tek kjo çështje  
3 ne po i marrim dokumentet një nga një, copë-copë. Prokuroria  
4 ka pesë vjet që punon dhe duhet të ishte gati. Ata e kanë  
5 paraqitur Aktakuzën para një vit e gjysëm dhe tani nuk janë  
6 gati. Ankohen se po përpiqemi të prioritarizojmë, jemi të  
7 zënë, kemi punë të tjera.

8 Pyetja ime është: "Përse e bënë atëherë Aktakuzën?" Na  
9 keni vënë në një pozitë ku klientët tanë, kanë humbur lirinë,  
10 kanë humbur prezumimin e pafajësisë sepse Prokuroria nuk është  
11 gati dhe ne po marrim materiale sipas tekave të tyre.

12 Është shumë vështirë për ne që të komentojmë, duke pasur  
13 një pamje jo të plotë, dhe kjo është shqetësuese për ne dhe  
14 shkel edhe të drejtat ndërkombëtare, instrumentet e të  
15 drejtave të njeriut. Ju kërkojë ndjesë që po i them, se mbase  
16 po humb durimin tuaj, po është një gjë që neve na shqetëson  
17 dhe duhet rregulluar menjëherë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

19 Z. Kaufman apo dikush tjetër për këtë temë konkrete.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Keni dëgjuar  
21 shumë nga unë në konferencat e tjera lidhur me këtë qasje.  
22 Kështu që, unë po ja lë fjalën z. Kaufman dhe kjo vlen për  
23 tani e tutje për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me  
24 menaxhimin e çështjeve, për mënyrën se si po zhvillohen këto  
25 procedura.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.

2 Z. Kaufman.

3 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po. Për këtë  
4 çështje konkrete, ne e kemi trajtuar gjerë e gjatë në  
5 paragrafin 3 të parashtrimit tonë 315, do të shtoja vetëm se  
6 nuk duam të kufizohemi nga ndonjë format tabelar, për arsyen e  
7 thjeshtë sepse gjykimi është një proces dinamik. Ne nuk mund  
8 t'i parashikojmë paraprakisht se çfarë kundërshtime mund të  
9 kemi lidhur me provat për sa i takon pranueshmërisë.

10 I bashkëngjitem edhe kolegut Prosper, që tha se "nuk  
11 mund të themi asgjë pa marrë të gjithë provat nga Mbrojtja."  
12 Faleminderit shumë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

14 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Shkurt.

15 Mbështesë ato që thanë kolegët, në lidhje me momentin e  
16 papërshtatshëm për të komentuar tani për pranueshmëri. Me  
17 gjithë respektin e duhur, kundërshtimet tona do t'i bëjmë kur  
18 të mësojmë se çfarë do të përmbajë çështja e prokurorisë.  
19 Çfarë provash do të përdorin ata? Çfarë dëshmitarësh? Pra, nuk  
20 jemi në këtë fazë.

21 Për sa i takon formatit në formë tabelash, edhe me atë do  
22 të merremi kur të vijë momenti i duhur.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po për kategoritë e  
24 ndryshme që kam propozuar në këtë formatin e tabelave jeni  
25 dakord?

1 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe këtë  
2 çështje do ta shqyrtojmë, i nderuar Gjykatës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.  
4 Young.

5 Znj. Alagendra apo Ellis.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] jemi në  
7 qëndrimin që kemi mbajtur në paragrafin 8 të parashtrimit  
8 tonë. Nuk jemi në gjendje as ne të japim një afat kohor.

9 Për sa i takon formatit, në formë tabelash, ne nuk kemi  
10 problem që të përfshijmë aty përmbledhjen dhe grupimin e  
11 kundërshtimeve por, argumentet duhen bërë në formë  
12 parashtrimi.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Tani i kthehem, i drejtohem Prokurorisë. Keni ndonjë  
15 koment për këtë temë, prokurore?

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Siç e vini në dukje në programin  
17 tuaj çështjet e pranueshmërisë trajtohen në bazë të rregullës  
18 95(2)(e), dhe për sa i takon kundërshtimeve edhe ato do të  
19 pasqyrohen nga ZPS-ja në listën e provave në bazë të rregullës  
20 95(4).

21 Në rast se do të ketë kundërshtime, ne si Prokurori,  
22 mendojmë që formati, në formë tabelle, mendojmë që do të ishte  
23 i dobishëm për palët dhe për panelin. Padyshim që jeni ju që  
24 do të përcaktoni drejtimin për mënyrën e zhvillimit të  
25 ecurisë të procesit dhe për të dhënë vendim lidhur me çështjet

1 e pranueshmërisë. Ne i kuptojmë të gjitha këto, dhe pajtohemi  
2 me propozimin tuaj.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

4 Nuk shoh ndonjë njeri nga ekipi i mbrojtjes që të kërkojë  
5 fjalën. Kështu që, vazhdojmë me temën tjetër që kemi në  
6 agjendë, që është -- ka të bëjë me hetimet e ZPS-së dhe hapat  
7 e mëtejshëm.

8 Dua ta pyes ZPS, nëse mund të na japi ndonjë përditësim  
9 lidhur me datën për të përfunduar hapat hetimorë dhe kur ZPS-  
10 ja do të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen paraprake dhe  
11 materialet e lidhura me të. Dua të vë në dukje se data e  
12 synuar është mesi i tetorit 2021, si mbas parashtrimeve të  
13 tyre me shkrim. Gjithashtu, dua që ata të bëjnë parashtrime  
14 lidhur me kalendarin procedural, po, për këtë çështje.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit i nderuar.

16 Parashtrimi ynë lidhur me hetimet është i pandryshuar siç  
17 e kemi vënë në dukje në parashtrimet me shkrim. Hetimet në  
18 përmbushjen e mandatit tonë parashikohet të vazhdojnë për një  
19 të ardhme të parashikueshme, por kjo nuk do të ndikojë në  
20 afatin e paragjykimit.

21 Neve jemi të vetëdijshëm se do të na kërkohet autorizim  
22 gjyqësor dhe kur të dalin materiale shfajësuese, ato do t'i  
23 nënshtrohen nxjerrjes.

24 Lidhur me rregullën 95(4) materialet e kësaj rregulle  
25 janë në listat e dëshmitarëve dhe të provave. Ne jemi në

1 gjendje që këto materiale t'i paraqesim në mesin e tetorit  
2 2021. Ka një ndryshim nga parashikimi që kishim bërë përpara  
3 në shtator.

4 Siç thamë, në parashtrimet e mëparshme në konferencën e  
5 fundit dhe në parashtrimet me shkrim, data e -- në shtator  
6 ishte data më e hershme e parashikuar nga ne për të dhënë  
7 materialet në atë kohë. Që atëherë, na është bërë e qartë se  
8 të gjitha burimet tona do të punojnë për të përfunduar  
9 nxjerrjen e materialeve. Jemi në fazën kritike të këtij  
10 procesi dhe duke e pasur parasysh problemet logjistike, ka  
11 dalë një punë që na i ka marrë të gjitha burimet tona.

12 Prandaj, ne parashikojmë që t'i vazhdojmë deri në shtator  
13 2021 këto përpjekje. Dhe duke pasur parasysh të gjithë këto  
14 faktorë që përmenda, ne kemi paraqitur një datë tjetër.

15 Për sa i takon kalendarit, parashtrimi ynë është do të  
16 mbetet siç ka qenë. Pra, do t'i bëjmë parashtrimet lidhur me  
17 kohën e propozuar dhe dorëzimin e dosjes paraprahe.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Prosper, ju lutem.

20 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

21 I nderuar Gjykatës, mendoj që e vetmja mënyrë për të  
22 përshkruar reagimin tim është që kam mbetur pa gojë.  
23 Prokuroria thotë se kërkon që të kemi durim nga ne dhe se kanë  
24 shumë punë për të bërë. Është një punë që ka përfshirë gjithë  
25 pjesëtarët e zyrës. Këtë unë e kuptoj, dhe duhet të jetë një

1 përpjekje e bërë nga të gjithë zyra se nuk kanë mandat tjetër  
2 përveç kësaj. Unë nuk e di se çfarë tjetër mund të bëjnë këta.

3 Dhe kjo më sjell tek pika ime: Përse jemi këtu në qoftë  
4 se ata nuk janë gati? Përse jemi këtu në qoftë se hetimet janë  
5 akoma në vazhdim? Është një çështje që ka të bëjë me procesin  
6 e rregullt që lidhet me të drejtat e njeriut. Të akuzuarit  
7 kanë të drejtë të dinë se përse akuzohen dhe nuk e dimë.  
8 Prokuroria vazhdon të thotë "se jemi duke bërë hetime të cilat  
9 do të vazhdojnë në një të ardhme të parashikueshme". Cila  
10 është kjo e ardhme e parashikueshme?

11 Unë mund të them, mund të flasë p.sh., për 2030. Për këtë  
12 afat flasim? Ne duhet ta dimë se për çfarë po bëhet fjalë  
13 këtu. Ju e keni parë sesi ata i ndryshojnë datat. Në këtë pikë  
14 po them që kemi një -- po bëhet fjalë për njerëz të privuar  
15 nga liria, nga e drejta e tyre. Në një farë kuptimi për të  
16 pasë një proces të drejtë, të rregullt. Janë të privuar nga  
17 prezumimi i pafajësisë dhe Prokuroria kërkon -- thotë "është  
18 një përpjekje, një punë e madhe e gjithë zyrës". Klienti, të  
19 gjithë klientët tanë rrinë në paraburgim, larg nga familjet  
20 dhe nuk e dinë ende të gjithë tërësinë e akuzave të ngritura  
21 kundër tyre, pikërisht, sepse Prokuroria nuk është gati.

22 Ndërsa Prokuroria vazhdon hetimet në të ardhmen e  
23 parashikuar, atëherë duhet t'i kthehemi çështjes së lirimit të  
24 përkohshëm të klientëve tanë për një të ardhme të  
25 parashikueshme dhe kur Prokuroria të jetë gati, të mblidhemi

1 dhe ta rifillojmë përsëri çështjen. Më falni, i nderuar  
2 Gjykatës, për pasionin që po shfaq, por kjo shkel çdo normë të  
3 të drejtave të njeriut që lidhet me proceset e rregullta  
4 gjyqësore, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e të  
5 tjera. Dhe është një -- krijon një ide negative për këtë  
6 institucion, duke e lejuar që të ndodhë kjo gjë, do ta  
7 njollosë edhe më tej këtë institucion për të ardhmen.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.  
9 Z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Përpara se  
11 t'ia jap fjalën znj. Katlin (siç u përkthye).

12 Ju mbase ju kujtohet, se në fazat e hershme të  
13 procedurave, unë e parashikova në fakt, që afati i parashikuar  
14 nga Prokuroria ishte krejtësisht absurd. Dhe atëherë  
15 Prokuroria, më akuzoi mua, në fakt u akuzova edhe në një takim  
16 privat nga kryetari i Tribunalit, që dhashë një parashikim jo  
17 të rremë të themi për kohëzgjatje e fillimit të gjyqit kur  
18 thashë, kur bëra kërkesë për lirimin e përkohshëm. Ky ishte  
19 qëndrimi që kryetari -- kryetarja vetë ua transmetoi  
20 kryetarëve të shteteve në një takim evropian, në një takim.

21 Tani, jemi në një situatë, që ajo që thashë unë atëherë  
22 do të ndodhë. Prokuroria tani po përmend shtatorin, datën që e  
23 sugjeroi në fillim për fillimin e gjyqit. Madje këmbënguli që  
24 ta fillonim dhe se çdo afat tjetër do ishte një abuzim nga  
25 Mbrojta për të dhënë -- për të bindur gjykatësin të jepte



1 lirimin e përkohshëm. Ne ende nuk kemi ndonjë indikacion se  
2 kur do të dorëzohet dosja paraprake, duhet të ishte dorëzuar.  
3 Siç tha z. Prosper me të drejtë, këta njerëz janë në  
4 paraburgim në bazë të faktit se procedura do të përfundonin  
5 dhe do të fillonte gjyqi.

6 Fakti i çështjes është se Prokuroria është copë-copë në  
7 punën e saj dhe këta burra, njerëz po mbahen në paraburgim  
8 pafundësisht tek sa Prokuroria po përpiqet të paraqesë  
9 çështjen e saj në një farë renditjeje.

10 Unë nuk e di nëse ju keni pasur rast t'i shikoni mocionet  
11 paraprake, përgjigje-kundërpërgjigje, por nga ato shihet që  
12 kemi të bëjmë me një çështje shumë të vërtetë, nëse kjo  
13 gjykatë ka juridiksion të gjykojë ndërmarrje kriminale të  
14 përbashkëta apo përgjegjësi komanduese si çështje  
15 përgjegjësie. Këto janë çështje të cilat nuk do të hiqen  
16 kollaj. Janë çështje të cilat janë marrë përsipër -- janë  
17 diskutuar nga Gjykata Kushtetuese Serbe. Është e pamendueshme  
18 që, -- kjo gjykatë duhet të mbështetet në sistemin ligjor të  
19 Kosovës dhe duhet t'i trajtojë të akuzuarit, jo në këtë mënyrë  
20 diskriminuese siç i ka trajtuar gjykata serbe.

21 Fakti është që përgjegjësia komanduese, ndërmarrja e  
22 përbashkët kriminale dhe nuk kanë qenë krime në Kosovë në  
23 kohën që kanë ndodhur këto ngjarje. Gjykata Kushtetuese e  
24 Serbisë e ka pranuar dhe ka deklaruar se njerëzit nuk mund të  
25 dënohen për këto çështje sepse nuk ka pasur juridiksion.

1 Edhe gjykata jua j është në të njëjtën pozitë dhe të  
2 dalësh me një konkluzion tjetër, do të ishte padrejtësi  
3 marramendëse. Këta burra rrinë në paraburgim kur Prokuroria po  
4 e akuzon Mbrojtjen se nuk ka vepruar si duhet në vlerësimin e  
5 fazës paraprake, kur ajo vetë ka propozuar shtatorin për  
6 fillimin e datës si bazë për të rezistuar, për të kundërshtuar  
7 lirimin e përkohshëm.

8 Kemi një situatë ku rezultati i vetëm, i arsyeshëm do të  
9 ishte se kjo gjykatë nuk ka juridiksion për të gjykuar vepra  
10 të ndërmarrjes kriminale të përbashkët.

11 Në rastin e z. Veseli, në bazë të provave që janë nxjerrë  
12 deri tani nuk ka asnjë akuzë që ai ka kryer një krim, nuk ka  
13 asnjë akuzë të vetme se ai ka bashkëpunuar, nuk ka asnjë të  
14 vetme se ai ka nxitur apo ka ndihmuar ndonjë ndërmarrje të  
15 tillë kriminale. Nuk ka çështje kundër tij, në qoftë se sfida  
16 juridiksionale është e saktë. Mbase Prokuroria mban diçka të  
17 fshehtë. Shpreson se diçka do të dali me kalimin e kohës. Por  
18 ju jeni këtu. Po kryesoni procedura për një çështje ku katër  
19 burra kanë humbur të drejtën e tyre për një kohë të gjatë edhe  
20 pse z. Veseli dhe z. Thaçi e dinin që gjashtë muaj përpara për  
21 këtë gjë dhe me gjithë garancitë e ofruara dhe megjithëse z.  
22 Veseli u lejua të largohet përkohësisht për të cilën ai është  
23 shumë mirënjohës gjykatës, për të parë babanë e tij shumë të  
24 sëmurë.

25 Ne jemi në një situatë ku, Prokuroria po vepron shumë

1 qartësisht në mënyrën jo të duhur. Dhe po e përsëris,  
2 Prokuroria jo vetëm e akuzoi Mbrojtjen padrejtësisht se po  
3 sugjeronte qëllimisht zgjatjen e procesit -- fillimit të  
4 procesit dhe tani vijnë këtu dhe thonë që nuk mund ta fillojnë  
5 çështjen përpara se të jenë gati. Po, kryetari i gjykatës në  
6 prani të Prokurorisë, të Prokurorit në një takim privat e ka  
7 bërë të njëjtën kundër-akuzë kundër Mbrojtjes.

8 Kjo situatë, po vjen në një moment pa krye dhe ju kërkojë  
9 që të siguronit që këta burra të mos mbahen më në paraburgim  
10 dhe mocionet paraprake të trajtohen sa më shpejtë që të jetë e  
11 mundur, ndryshe do të shikoni se kjo gjykatë do të mbajë katër  
12 burra në paraburgim, pa i filluar ende gjyqin.

13 Për sa i takon hollësitë e shqetësimit e mia këto do të  
14 bëhen të njohura më vonë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z.Kaufman, ju lutem fjala  
16 për ju. Shkurtimisht.

17 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar  
18 Gjykatës, nuk kam asgjë tjetër për të shtuar përveç asaj që u  
19 tha nga z. Emmerson dhe z. Prosper.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

21 Z. Young, fjala për ju.

22 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar, do  
23 të doja që t'ju drejtohesha lidhur me këtë çështje sepse  
24 singerisht, sapo dëgjuam për afatin kohor nga Prokuroria dhe  
25 shpresoj që afati i thënë, i përmendur nga Prokuroria është

1 alarmues për ju sepse është absolutisht jo i kënaqshëm që të  
2 pranojmë një afat të tillë kohor siç u parashtrua nga  
3 Prokuroria.

4 Siç u tha, pra, neve mund të themi se një prej  
5 statistikave më domethënëse është tipari ose le të themi  
6 elementi i përkthimit me të cilin juve e filluat këtë seancë  
7 gjyqësore. Dhe ndërkohë duhet që dokumentet më të rëndësishme  
8 do të duhet që të përkthehen në shqip. Flasim këtu për  
9 informacione apo dosjen, për përshkrimin e detajuar të cilat  
10 ende nuk na janë vënë në dispozicion në versionin e tyre të  
11 përkthyer në shqip.

12 Dhe siç e thatë dhe në konferencën e fundit, zoti  
13 Gjykatës, pra, kjo është shumë e vështirë për ne, për  
14 Mbrojtjen sepse të akuzuarit kanë të drejtë që të lexojnë  
15 pretendimet e Prokurorisë në gjuhën e tyre. Në një situatë të  
16 tillë, ku ata nuk mund të lexojnë as edhe një ndër dokumentet  
17 më të rëndësishme që kanë të bëjnë me pozicionin e tyre, në  
18 versionin në shqip, dhe po flasim tani për qershorin, çfarë ju  
19 thotë kjo juve, i nderuar Gjykatës, ndërkohë që ky është vetëm  
20 një prej mijëra dokumenteve?

21 Sa i takon shërbimeve të përkthimit, ata janë munduar që  
22 të përcaktojnë përparësinë për to, por ndërkohë një ndër  
23 dokumentet më të rëndësishme është ende i papërkthyer dhe  
24 ndërkohë tani jemi thuajse në qershor. Pra, në këtë aspekt  
25 situata është shumë e pakënaqshme. Ne duhet të ishim të

1 përgatitur të gjithë shumë herë, më herët dhe këto çështje kaq  
2 shumë të rënda, kaq shumë të rëndësishme sa i takon  
3 përgatitjes për procesin gjyqësor dhe dhënia e mundësisë  
4 Mbrojtjes për të shqyrtuar provat. Sepse si mund të hetojmë ne  
5 kur të pandehurit apo të ndaluarit akoma nuk kanë pasur  
6 mundësinë të lexojnë dokumentet më të rëndësishme në një gjuhë  
7 që ata e kuptojnë?

8 Pra, kjo në vetvete, është një çështje shumë shqetësuese,  
9 i nderuar Gjykatës. Kështu që do të doja t'ju kërkoja, që kur  
10 të rishikoni vendimin tuaj sa i takon, pra, lirim të  
11 përkohshëm dhe kjo duhet të merret parasysh seriozisht prej  
12 jush.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

14 Znj. Alagendra, fjala për ju.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I

16 nderuar, dua të mbështes atë çfarë u tha nga kolegët e mi deri  
17 tani, dhe për momentin nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

19 Alagendra.

20 Përpara se t'i jap fjalën Prokurorisë, do të doja t'i  
21 përgjigjesha shkurtimisht asaj çfarë u tha deri tani dhe dua  
22 t'u kujtoj të gjithëve, atyre që janë të pranishëm në këtë  
23 sallë gjyqi dhe të tjerëve që na ndjekin në distancë që  
24 sigurisht që të gjithë të akuzuarit prezumohen të pafajshëm  
25 dhe kjo është diçka që duhet ta kemi parasysh.

1 Zonja prokurore, fjala për ju për t'ju përgjigjur  
2 pyetjeve dhe qëndrimeve të Mbrojtjes.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

4 Po, ZPS-ja që nga fillimi ka përcaktuar objektiva  
5 ambicioze për veten dhe do të vazhdojë të bëjë këtë gjë. Ne në  
6 të njëjtën kohë, mirëpresim dhe inkurajojmë menaxhimin aktiv  
7 të procesit paragjyqësor. E kemi bërë këtë gjë duke e ditur që  
8 barra kryesore për nxjerrjen na takon ne, dhe e bëjmë këtë gjë  
9 në interes të proceseve të drejta dhe të shpejta dhe po e  
10 bëjmë këtë gjë për të siguruar që nxjerrja e informacioneve  
11 për Mbrojtjen të jetë e përfunduar në kohën më të shpejtë të  
12 mundshme që mund të përfundojë. Është Prokuroria ajo, e cila  
13 ka vijuar në të gjithë kohën dhe që të shtyjë këto procedura  
14 përpara.

15 Mbrojtja bëri disa parashtrime të përgjithshme sa i takon  
16 progresit dhe ecurisë së çështjes. Megjithatë, ZPS-ja ka bërë  
17 dhe vazhdon të bëjë progres të mirë lidhur me nxjerrjen. Nuk  
18 ka absolutisht asgjë përjashtimore të posaçme apo në shkelje  
19 të të drejtave dhe normave sa i takon progresit të procesit  
20 paragjyqësor për këtë lëndë.

21 Së fundi, sa i takon pyetjeve të paraburgimit, do të doja  
22 të thosha që kohët e fundit Mbrojtja nuk e ka përdorur  
23 mundësinë që të bëjë parashtrime që kanë të bëjnë me afatin  
24 kohor të rishikimit të mbajtjes në paraburgim.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja

1 prokurore.

2 Nuk e di se në qoftë se nga Mbrojtja do të marrë fjalën.

3 Z. Emmerson, ju lutem shkurtimisht.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do të flasë  
5 shkurtimisht.

6 Kur thatë që, Prokuroria ka përcaktuar objektiva  
7 ambicioze për veten, do të doja që t'ju drejtoja edhe një herë  
8 pyetjen sa i takon parashtrimin, i cili nuk është përgjegjor  
9 prej jush.

10 Prokuroria ka ardhur para jush në mënyrë të përsëritur  
11 dhe ka dhënë në parashtrimet e shkruara qëndrimin e saj që do  
12 të ishte në pozicionin që të fillojë dhe të çelet procesi  
13 gjyqësor në shtator. Ndërkohë, që tani na thotë që nuk është  
14 gati as që të nxjerrë materialet për të filluar hetimet deri  
15 në shtator. Dhe kjo pa diskutim, siç u tha edhe nga kolegët e  
16 mi është një çështje shumë serioze për katër burra, për katër  
17 njerëz që vazhdojnë që të jenë në paraburgim. Dhe siç thashë,  
18 kjo gjithashtu lidhet edhe me pretendimin shumë të fortë për  
19 juridiksionin e gjykatës.

20 Megjithatë, shqetësimi kryesor - që nuk është përgjegjor  
21 ende -, [që] nuk ka marrë ende përgjigje është që Prokuroria  
22 bën pretendime kundër Mbrojtjes, në përgjithësi dhe kundër  
23 meje në veçanti që neve i kemi dhënë gjykatës një vlerësim  
24 artificialisht të zgjatur për periudhën e paragjyqimit në  
25 mënyrë që të mbështeten themelet, meritat e kërkesave për

1 lirim të përkohshëm. Ndërkohë që një parashtrim i tillë u  
2 është bërë shumë herë në mënyrë të përsëritur.

3 Edhe, siç e thashë dhe më përpara, nga kryetarja e  
4 gjykatës dhe nga z. Black vetë, gjatë një takimi me krerët e  
5 BE-së, që është -- e misionit të BE-së që është një çështje  
6 shqetësuese.

7 Megjithatë, domethënë, unë pres që të kem, le të themi  
8 një - të më kërkohet falje nga Prokuroria, pra, të më thonë që  
9 pretendimi në emrin tim dhe në emrin e mbrojtësve të tjerë ka  
10 qenë i padrejtë. Sepse, siç e kemi parashikuar edhe më parë,  
11 prokuroria është rreth një vit pas kohës, që ka deklaruar se  
12 do ishte gati më parë.

13 Kështu që, nuk ka mundësi që të fillojë ndonjë proces  
14 gjyqësor real deri nga mesi i vitit që vjen. Dhe nga ana  
15 tjetër, ne nuk e dimë se çfarë duhet të hetojmë. Nuk e kemi  
16 idenë se çfarë duhet të hetojmë. Pra, duhet që të hetojmë për  
17 bazën e krimit, ndërkohë që nuk e dimë akoma në qoftë se  
18 gjykata ka juridiksion për ndërmarrje kriminaleve të  
19 përbashkët. Pra, si mund ta fillojmë një proces hetimi kur nuk  
20 ka pretendime për kryerjen ose bashkëkryerjen e krimeve kundër  
21 klientit tim?

22 Dhe ndërkohë duke qenë se është kështu, pra, duke qenë që  
23 mund të pritët që procesi të nisë nga mesi i vitit tjetër.  
24 Pretendimet të cilat janë ngritur nga ZPS-ja në mënyrë të  
25 vazhdueshme gjatë kohës kur kemi dhënë dhe kemi bërë kërkesën



1 për lirim të përkohshëm edhe pretendimet e ngritura nga  
2 kryetarja, nga z. Black përpara krerëve të misionit të  
3 Bashkimit Evropian janë false dhe janë të padrejta. Dhe kështu  
4 që besojë që kemi të drejtën që të na kërkohet falje.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.

6 Ndonjë nga Mbrojtja, ndonjë ekip tjetër do të marrë  
7 fjalën? Nuk shoh ndonjë person që ka ngritur dorën. Nuk e di  
8 në qoftë se ZPS-ja dëshiron t'i përgjigjet z. Emerson.

9 Shumë shkurtimisht, ju lutem.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund t'i kthehem aftësisë për të  
11 hetuar mbështetur në program. Megjithatë, informacionet dhe  
12 materialet që kanë qenë të disponueshme për Mbrojtjen, janë  
13 theksuar në raste të tjera dhe vazhdojmë të themi, që afatet  
14 kohore të parashikuara nga Mbrojtja janë të fryra dhe nuk ka  
15 arsye të qenësishme sepse Mbrojtja nuk i ka nisur ende hetimet  
16 e saj.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
18 prokurore.

19 Nuk shoh që ndonjë tjetër do të marrë fjalën. Në qoftë se  
20 është ky rasti, atëherë kalojmë tek pika tjetër që është  
21 hetimi i Mbrojtjes dhe hapat pasues.

22 Do të doja që të dëgjoja nga Mbrojtja, sa i takon  
23 gjendjes së hetimeve të saj. Në veçanti, në qoftë se  
24 mbështetur në vlerësimet e ZPS-së edhe proceset në vijim të  
25 nxjerrjes, Mbrojtja, mund të japë më shumë informacion sa i

1 takon gjendjes së hetimeve të tyre. Në qoftë se, Mbrojtja mund  
2 të japë informacion për synimet e saj për të bërë kërkesa në  
3 lidhje me mundësitë unike hetimore në përputhje me rregullën  
4 99(1), dhe nëse Mbrojtja mund të japë informacion për synimet  
5 për të njoftuar një alibi ose shkaqe për të përgjegjësinë  
6 përjashtuese.

7 Z. Prosper fjala për ju.

8 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
9 i nderuar.

10 Do flas shkurt lidhur me këtë pikë.

11 Mendojë që për të ardhmen e parashikueshme, ne  
12 fatkeqësisht, nuk kemi mundësi që t'i japim detaje sa i takon  
13 këtyre çështjeve. Domethënë do na duhet që të marrim më shumë  
14 informacion nga Prokuroria për të qenë në gjendje për të dhënë  
15 më shumë detaje.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

17 Z. Emerson ose z. Kaufman?

18 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do  
19 përgjigjem unë lidhur me këtë.

20 Ne kemi krijuar një ekip hetimor. Jemi në pozitë që të  
21 fillojmë me hetimet, megjithatë, e kemi bërë ushtrimin e parë  
22 të triazhit dhe të ushtrimeve, apo le të themi, të skicimit  
23 mbështetur në provat që kemi marrë nga Prokuroria. Dhe siç e  
24 kam thënë, në çudinë time, nuk ka qoftë edhe një akuzë të  
25 vetme, një pretendim të vetë kundër z. Veseli për një sjellje

1 specifike që mund ta çojë atë në një hetim lidhur me kryerjen  
2 e një krimi ose pjesëmarrje në një krim. Jemi përpara  
3 përzgjedhjes që, ose të mos bëjmë asgjë apo të hetojmë  
4 elementë ose gjëra shumë të vogla në të cilat ai del, në prova  
5 që kemi në dispozicion, në kapacitet ose në një pozitë jo  
6 penale. Pra, për momentin ne nuk kemi prova dhe nuk e dimë se  
7 çfarë juridiksioni ka gjykata në mënyrë që të hetojë këto  
8 akuza.

9 Kështu që, në pak fjalë, do të thosha që vetëm një  
10 mbrojtje e çmendur, duke pasur parasysh domethënë burimet e  
11 kufizuara, ajo që kemi në dispozicion, mund të fillojë të  
12 hetojë krimet që ka të ngjarë të mos jenë fare si pesë e  
13 juridiksionit të kësaj gjykate. Dhe provat, siç thashë që kemi  
14 në dispozicion deri tani për z. Veselit, nuk tregojnë asnjëra  
15 kryerjen e ndonjë krimi nga z. Veseli.

16 Megjithatë, në qoftë se Prokuroria nuk ka ndonjë gjë që  
17 ende po e mban për vete e nuk na e ka dhënë, gjë e cila do të  
18 ishte shkelje shumë serioze e procesit të drejtë juridik ose  
19 në qoftë se nuk kanë fare gjë për të inkriminuar z. Veseli. Ne  
20 aktualisht nuk kemi asgjë për z. Veseli. Çfarë hetimi mund të  
21 bëjmë ne lidhur me të? Është e vërtetë që ne mund të bëjmë  
22 hetim për bazën e përgjithshme të krimit, në qoftë se kjo  
23 është e nevojshme, por shpresojë që në qoftë se do të kishit  
24 lexuar përgjigjet për kundërshtimin e juridiksionit, besojë që  
25 do ta kishit kuptuar që asnjë skuadër, asnjë ekip mbrojtjeje i

1 përgjegjshëm nuk do ndërmerrete një hetim të tillë në 42 vende  
2 të ndryshme në gjithë Kosovën dhe Shqipëri ndërkohë që në  
3 dokumentacionet dhe shkresat që kemi deri tani nga Prokuroria,  
4 nuk kemi asnjë indicie për përfshirjen e klientëve tanë në  
5 krimet në fjalë.

6 Kështu që siç tha z. Prosper, çfarë lloj prokurorie bën  
7 këtë që ka bërë Prokuroria aktuale, që ka nxjerrë Aktakuzat,  
8 ndërkohë që nuk është e gatshme për të vijuar me procesin  
9 gjyqësor. Dhe cila është ajo Prokurori e cila gjashtë muaj  
10 përpara ka bërë thjeshtë -- ka bërë të mundur, pra, fillimin e  
11 Procedurës Paraprake ndërkohë që nuk është e gatshme për të  
12 vijuar me plotësimin e detyrimeve të saja?

13 Dhe do të doja të thosha edhe një herë, çfarë mund të  
14 bëjmë ne sa i takon hetimeve? Ndërkohë që është absolutisht  
15 shumë e vështirë për neve se çfarë hetimesh të bëjmë. Ne na  
16 rezulton që thuhet se nuk kemi asgjë për të hetuar në këtë  
17 pikë dhe nga ana tjetër, në qoftë se kjo gjykatë ndjek të  
18 njëjtën qasje që është ndjekur në fund të vitit që shkoi nga  
19 Gjykata Kushtetuese dhe një gjykatë bashkiake në Kosovë. Pra,  
20 në qoftë se do të ndiqej e njëjta teori dhe në qoftë se ju do  
21 të vendosni që të mos i trajtoni shqiptarët ndryshe nga --  
22 shqiptarët e Kosovës nga serbët për të njëjtat krime, për të  
23 njëjtat zhvillime, neve pretendojmë që nuk duhet të ketë fare  
24 proces gjyqësor sepse ju nuk keni juridiksion që të gjykoni.

25 Kështu që çfarë mund të bëjë Mbrojtja në një situatë të

1 tillë? Pse na kërkohet ne që të shprehemi për gjendjen ose  
2 ecurinë e hetimeve? Ndërkohë, që fakti dhe çështja është që  
3 një gjykatë e tillë apo çdo person që është i përfshirë me  
4 Dhomat e Specializuara, domethënë qoftë nga Zyra e  
5 Administrimit por edhe nga ZPS-ja. Pra, ju harroni faktin që  
6 kjo është Gjykatë e Kosovës, nuk është Gjykatë Kriminale  
7 Ndërkombëtare dhe për këtë arsye, pra, duhet të merrni  
8 parasysh kushtetutën.

9 Pra, të pandehur kosovarë dhe serbë pretendohen që të  
10 kenë kryer krime, pra, në të njëjtin kontekst, të njëjtat  
11 krime në përputhje me të njëjtën ligj të zbatueshëm, sepse  
12 ligji ka qenë i njëjtë sipër kosovarët dhe për shqiptarët në  
13 atë kohë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju kërkojë ndjesë z.  
15 Emmerson, se nuk është koha kjo që të diskutojmë këtë çështje.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, me  
17 respekt ju them, që është pikërisht kjo çështja.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, po flasim për hetimin  
19 tuaj. Absolutisht e kuptojë mesazhin tuaj. Mbajta shënim  
20 gjithçka që ju thatë. Megjithatë, më lejoni të them që nuk do  
21 të diskutojmë detaje lidhur me atë çfarë ju ngritët. Kjo do të  
22 jetë pesë e vendimit tim për mocionet paraprake.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Besoj se i  
24 keni lexuar dokumentet tona dhe mendoj që, mbështetur në ato  
25 që keni parashtruar, nuk ka vlerë që ju të na pyesni neve, si

1 Mbrojtje, se në çfarë faze hetimesh jemi. Pra, unë nuk do të  
2 filloj që t'i përgjigjem kësaj pyetjeje deri kur kjo gjykatë  
3 të fillojë që të sillet në të njëjtën status si Gjykata  
4 Kushtetuese Serbe.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young, fjala për ju.

6 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar, në  
7 këtë fazë nuk mund t'ju ndihmojmë sa i takon hetimeve. Pra,  
8 neve po kalojmë me shpejtësi informacionin që na është  
9 dorëzuar nga ZPS-ja, por ndërkohë, nuk mund të jap informacion  
10 sa i takon ecurisë së hetimeve.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

12 Znj. Alagendra.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Neve i  
14 qëndrojmë parashtrimeve me shkrim dhe nuk jemi në gjendje që  
15 të japim përditësime të tjera lidhur me këtë pikë, në këtë  
16 fazë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] ZPS-ja, nuk e di nëse doni  
18 t'i përgjigjeni kësaj çështjeje?

19 Po fjala për ju, zonja prokurore.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit i nderuar.

21 Mbrojtja e Veselit, sërish, ngre çështjen që ata janë të  
22 penguar për të filluar me hetimin, përfshirë këtu edhe  
23 pezullimin ose mospërfundimin e nxjerrjes. Dhe kësaj here, ata  
24 e kanë ndryshuar, pra, qëndrimin e tyre për të bërë vendime  
25 për apele përfundimtare për mocione paraprake si parakusht për

1 këtë gjë.

2 Siç e kemi thënë edhe më parë, arsyet për të cilat  
3 ngrihen pretendime të tilla mund të justifikojnë hetimet e  
4 Mbrojtjes dhe pse ato nuk janë përfunduar apo nuk janë nisur  
5 ashtu siç duhet. Sa i takon parashtrimeve të gjata të bëra dhe  
6 nga Mbrojtja e z. Veseli, siç e thatë juve me të drejtë i  
7 nderuar Gjykatës, kjo nuk është seancë që ka të bëjë me  
8 juridiksionin e gjykatës.

9 Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
11 prokurore.

12 Nuk shoh ndonjë person tjetër që do të marrë fjalën  
13 lidhur me këtë pikë.

14 Viojmë me pikën gjashtë, në rendin e ditës për sot.

15 Pikat për çështjet e ligjit dhe të faktit.

16 Dua t'u kërkojë palëve që të shprehen në qoftë se ata  
17 kanë pasur mundësi që të identifikojnë [një] listë çështjesh  
18 të cilat mund të jenë objekt kundërshtimesh ose jo objekt  
19 kundërshtimesh.

20 Ftoj Mbrojtjen, që të na thotë në qoftë se një  
21 marrëveshje e tillë mund të arrihet përpara depozitimit të  
22 dosjeve paraprake ose, në qoftë se preferojnë që të mos  
23 përfshihen në një marrëveshje të tillë përpara dorëzimit të  
24 dosjeve përkatëse para procesit gjyqësor.

25 Prokuroria, fjala për juve.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Prokuroria i ka dhënë ekipeve të  
2 Mbrojtjes propozimet e fakteve të rëna dakord, më datë 17  
3 mars.

4 Ne kemi marrë përditësimet inter partes për këtë çështje  
5 nga ekipi i mbrojtjes së z. Thaçi dhe z. Selimi, por nuk kemi  
6 marrë përgjigje nga skuadrat e tjera për të akuzuarit e tjerë.

7 ZPS-ja është e ndërgjegjshme për nevojën për të provuar  
8 lëndën e saj në gjykim dhe nuk po kërkon ndihmë nga Mbrojtja  
9 për kë të gjë. Dhe në përputhje me procedurat efikase dhe në  
10 përputhje me rregullat e drejtimin e Gjykatësit e Procedurës  
11 Paraprake, ne i kemi bërë këto propozime për tu shqyrtuar nga  
12 Mbrojtja në mënyrë që ato të mund të përqendrohen.

13 Siç e thamë më parë, Mbrojtja është e lirë që thjeshtë të  
14 shprehet në marrëveshje ose jo në marrëveshje sa i takon kësaj  
15 çështje.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prosper.

17 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
18 i nderuar.

19 Që në fillim mendoj që duhet të sqarojmë që neve kemi si  
20 synim që këto procedura të jenë sa më efikase të jetë e mundur  
21 dhe kur të jetë e mundur, pra, të biem dakord. Neve e kemi  
22 marrë dokumentin që përmendi Prokuroria. Dhe një ndër pyetjet,  
23 në fillim fare, është në qoftë se tërësia e këtij dokumenti  
24 mendohet se do të ndryshojë? Domethënë, ky është grupi  
25 përfundimtar i fakteve, që na kërkon Prokuroria, që ne të biem



1 dakord apo jo?

2 Në qoftë se nuk e kemi këtë informacion, atëherë nuk jemi  
3 fare në pozitë që ta shqyrtojmë këtë informacion. Por sërish,  
4 do të doja të theksoja, se qëllimi ynë kryesor është që këto  
5 procedura të jenë sa më efikase të jetë e mundur.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prosper.

7 Z. Emerson.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do të flasë  
9 shumë shkurt.

10 Pra, fazat paraprake në të cilat është përfshirë

11 Prokuroria do të duhen që të respektohen.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

13 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Neve i jemi  
14 përgjigjur Prokurorisë lidhur me këto. Ende po i shqyrtojmë  
15 propozimet dhe do t'i japim më shumë informacion Prokurorisë  
16 në momentin kur të jemi gati.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra, fjala për  
18 ju.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar  
20 Gjykatës, ne i qëndrojmë asaj që kemi parashtruar me shkrim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja prokurore, keni diçka  
22 për t'u përgjigjur?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Thjeshtë, për pyetjen që bëri  
24 ekipi i mbrojtjes i Thaçit.

25 Në këtë fazë, faktet e propozuara që ka paraqitur

1 Prokuroria për shqyrtim, sigurisht, edhe gjatë kohës që do të  
2 zhvillohen procedurat, si ne, ashtu dhe Mbrojtja, mund të  
3 paraqesë fakte të tjera për marrëveshje por, në këtë fazë kjo  
4 është lista përfundimtare.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja  
6 prokurore. Nuk shoh ndonjë kërkesë tjetër për të marrë fjalën,  
7 atëherë të kalojmë tek pika tjetër e fundit e rendit të ditës.

8 Po para se t'ia jap fjalën palëve për caktimin e datës së  
9 ardhshme të konferencës për ecurinë e çështjes, vē re se  
10 mbrojtja e Veselit, Selimit dhe Krasniqit kanë thënë në  
11 parashtrimet e tyre të kohëve të fundit, që nuk kanë ndërmend  
12 të bëjnë parashtrime në lidhje me atë nëse ekzistojnë arsye  
13 për vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarve. Për sa i përket  
14 palëve dhe në lidhje me mbrojtjen e Thaçit, unë e kam shtyrë  
15 afatin për dorëzimin e parashtrimit deri në 31 maj 2021 dhe  
16 dua nga avokatët e tjerë mbrojtës që të informojnë Gjykatën  
17 nëse duan ta shtyjnë afatin e parashtrimeve të tyre, për  
18 bërjen e parashtrimeve apo nuk duan të bëjnë parashtrime siç  
19 kanë thënë në dokumentin që kanë dorëzuar.

20 Emmerson, ju lutem.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nën dritën e  
22 ngjarjeve që kanë ndodhur, ne kishim ndërmend të ngrinim  
23 çështjen e lirimit të përkohshëm në kohën e duhur mbas  
24 shqyrtimit të parë. Dhe duke pasur parasysh sesi po rrjedhin  
25 ngjarjet, është e përshtatshme që ne të bëjmë parashtrimet

1 tona në lidhje me rishikimin e paraburgimit në këtë fazë dhe  
2 në qoftë se ju e keni shtyrë afatin për z. Thaçi atëherë neve  
3 duam ta rishikojmë pozicionin tonë dhe mund të përdorim të  
4 njëjtin afat.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A ju kuptova drejtë që,  
6 data 31 maj, ju përshtatet edhe juve?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes]Po.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.  
9 Z Young.

10 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] A më dëgjoni se  
11 pse lidhjen nuk e kam të mirë?

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju dëgjojmë. Pamja  
13 ndonjëherë nuk është e mirë, po zëri dëgjohet mirë.

14 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mund të them këtë, z.  
16 Young?

17 Sapo thashë këtë që zëri dëgjohet mirë, ndaloi zëri juaj.

18 Z. Young nuk ju dëgjuam sepse lidhja nuk është e mirë. Për fat  
19 të keq për herë të parë që nga fillimi i kësaj seance edhe  
20 zëri u ndërpre. Kështu që, ju lutem, a mund të filloni edhe  
21 një herë nga e para?

22 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk ju dëgjova  
23 çfarë thatë, i nderuar Gjykatës. Nuk e kam lidhjen të mirë,  
24 shkëputet.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk ju dëgjojmë.

1 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam gjë për  
2 të thënë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young a mund të sugjeroj  
4 që ta hiqni pamjen edhe të përdorni vetëm zërin sepse gjatë  
5 këtyre minutave të fundit, nuk ju dëgjuam se çfarë thatë.

6 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po tani?

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dëgjohen disa fjalë po jo  
8 gjithçka, prandaj them është më mirë pa video. Përdoreni  
9 lidhjen vetëm për të komunikuar me zë, jo me pamje.

10 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë  
11 për të shtuar, vetëm do t'ju kontaktojmë sa më shpejt të jetë  
12 e mundur në lidhjen me çështjen e lirimt të përkohshëm.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po vetë për këtë, a doni ta  
14 shtyjë afatin edhe për ju në mënyrë që edhe ju të mund të  
15 dorëzoni parashtrime, ashtu siç tha apo siç ra dakord edhe z.  
16 Emmerson? Apo dëshironi që t'i qëndroni atij pozicioni që keni  
17 përmendur në parashtrimin me shkrim të kohëve të fundit?

18 E them këtë se nëse është kështu, unë do të jap një  
19 urdhër në fund të kësaj seance, për ta sqaruar këtë çështje.

20 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
21 i nderuar Gjykatës, është mirë edhe për ne që të shtyhet  
22 afati.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A ju përshtatet 31 maji?

24 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra të njëjtën

1 pyetje edhe për ju?

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne jemi  
3 dakord me të njëjtën shtyrje të afatit, pra, 31 maji është i  
4 përshtatshëm për ne.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, do t'u japë  
6 urdhër në fund të seancës në lidhje me këtë çështje.

7 Tani dua t'i pyes palët në lidhje me një datë të  
8 përshtatshme për konferencën e ardhshme për ecurinë e  
9 çështjes.

10 Zoti -- Znj. Lawson.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne vazhdojmë që të mirëpresim  
12 menaxhimin aktiv të fazës paraprake dhe, siç kemi thënë, jemi  
13 dakord që të bëhet një seancë tjetër ose një konferencë tjetër  
14 për ecurinë e çështjes në qershor. Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prosper.

16 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe ne jemi  
17 dakord që të bëhet konferenca tjetër në qershor, me një  
18 kërkesë. A është e mundshme që të bëhet mbasdite në mënyrë që  
19 të fle pak më shumë?

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Gjykata është fleksibël,  
21 por një problem, që një avokatët është në anën tjetër të  
22 planetit, kështu që mund të ishte shumë e vështirë për të. Do  
23 të bëjë konsultime me Zyrën Administrative në lidhje me këtë  
24 dhe të shohë se çfarë zgjedhje mund të gjejmë në lidhje me  
25 kohën, por e dimë që për ju z. Prosper, është koha më e pa

1 volitshme e ditës. Por do të përpigemi të gjejmë kohën që i  
2 përshtatet sa më mirë të gjithë pjesëmarrësve.

3 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
4 çfarëdo që është e përshtatshme për të gjithë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne jemi  
7 dakord me propozimin.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young. Për datën e  
9 konferencës së ardhshme.

10 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Më falni, po e  
11 humba edhe një pjesë të kësaj që u tha në lidhje, për shkak të  
12 lidhjes, por desha të them që ne mendojmë që të jetë në fund  
13 të qershorit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jemi  
16 dakord me qershorin.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të merrni një urdhër në  
18 lidhje me caktimin e datës me kalimin e kohës dhe palët mund  
19 të bëjnë parashtrime përpara datës, kur do të caktohet seanca  
20 e konferencës për ecurinë e çështjes. Në këtë pikë dua t'i  
21 kujtoj palët dhe pjesëmarrësit që të bëjnë njoftim paraprak,  
22 në qoftë se ndonjë nga parashtrimet e tyre kërkon nxjerrjen e  
23 informacionit konfidencial.

24 Zonja prokurore.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prosper.

2 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të  
3 shtuar.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë  
6 tjetër.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Më duket se  
9 z. Kaufman ka diçka për të shtuar.

10 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kaufman s'ju dëgjojmë.  
12 Më duket se e shkëputët mikrofonin.

13 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ju kërkoj  
14 ndjesë, i nderuar Gjykatës.

15 Un ë ngrita edhe dy çështje të tjera në parashtrimin tonë  
16 315. Një ka të bëjë me materialet sipas rregullës 106, dua të  
17 vë në dukje se Prokuroria ka nxjerrë dokumente të brendshme të  
18 punës dhe e-mail-et nga p.sh., nga UNMIK-u por nën dritën e  
19 përgjigjes që ka dhënë Prokuroria, që unë e kam cituar në  
20 parashtrimin tim, desha të ngre dy çështje:

21 E para, ne presim që materiali ose është shfajësues ose  
22 që ka rëndësi për Mbrojtjen të mos shqyrtohet nga Prokuroria.

23 E dyta, të mos shqyrtohet nga Prokuroria për të  
24 përcaktuar nëse duhet ta nxjerrin apo jo; dhe së dyti, përvoja  
25 na ka treguar se shënimet e hetuesve që kanë jo diskutime,

1 diskutimet e brendshme dhe që lidhen me besueshmërinë e  
2 dëshmitarëve, e tjerë, e tjerë. Ndonëse këto nuk janë  
3 shfajësuese, mund të jenë produkt i brendshëm pune dhe, sipas  
4 mendimit tonë, nuk janë immune nga nxjerrja e tyre. Në qoftë se  
5 dalin nga organizata të tjera si EULEX-i, UNMIK-u, Tribunali  
6 Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë apo Shërbimi  
7 Prokurorisë së Kosovës.

8 Dhe një çështje tjetër është ajo mënyra sesi i ka bërë  
9 redaktimet Prokuroria në lidhje me provat fajësuese sipas  
10 rregullës 102.

11 Sigurisht, arsyetimi që përdor DhSK-ja është -- e dimë,  
12 jemi në dijeni të asaj, po ka një kufi deri në çfarë mase mund  
13 të jepen masa mbrojtje dhe shumica e këtyre redaktimeve janë  
14 subjekt, janë objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga gjykatësi.

15 Dhe në parashtrimin tonë 295, ne kemi dhënë një numër për  
16 sasinë e dëshmitarëve për të cilët sipas llogarisë tonë, është  
17 kërkuar që të bëhet nxjerrje e vonuar nga Prokuroria. Unë  
18 mendojë se, vonesa deri në 30 ditë para gjykimit ka të bëjë me  
19 rreth 50 dëshmitarë dhe kjo është rreth 30 ditë para se të  
20 japin dëshmi ata në gjykatë. Unë e vë në pikëpyetje se si pret  
21 Prokuroria që Mbrojtja të bëjë hetimet e veta me këto pengesa  
22 që po i vendosë. Unë nuk jam personi i fundit këtu që po bëjë  
23 akuza për një taktikë të padrejtë. Por në qoftë se është e  
24 qëllimshme apo jo ne po pengohemi në punën tonë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kaufman.



1 Do t'ia jap fjalën Prokurorisë që të përgjigjet, pasi të  
2 kenë mbaruar parashtrimet e tyre Mbrojtja.

3 z. Young.

4 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam gjë për  
5 të shtuar. Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për  
8 të shtuar.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja prokurore.

10 Mund t'i përgjigjeni parashtrimeve të z. Kaufman?

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë mendova që këto u sqaruan nën  
12 çështjen në lidhje me nxjerrjen e materialeve.

13 Megjithatë, në lidhje me rregullën 106, siç e keni parë  
14 nga emaili që u citua, Prokuroria ka konfirmuar që i gjithë  
15 informacioni shfajësues që përmbahet në informacion, në  
16 dokumentet e brendshme do të nxirret dhe nuk ka ndonjë gjë që  
17 është kontroverziale apo e diskutueshme në këtë, në lidhje me  
18 këtë.

19 Për sa i përket redaktimeve, redaktimet janë të nevojshme  
20 për të mbrojtur dëshmitarët dhe informacione të tjera të  
21 ndjeshme dhe shqyrtohen me shumë kujdese edhe nga gjykata. Ne  
22 kemi dëgjuar Mbrojtjen e Veselit që ka kërcënuar që mund të  
23 refuzojnë të marrin pjesë në procedura. Tani ata thonë që do  
24 bëjnë petition që ose do të bëjnë kërkesë që të pezullohen  
25 procedurat.

1 Këto janë disa pretendime që nuk janë të bazuara dhe  
2 shumë të hiperpolizuara dhe të shoqëruara dhe me kërcënime.  
3 Mbrojtja sigurisht, mund të kërkojë masat ligjore që i gjykon  
4 të arsyeshme dhe ato të shqyrtohen nga gjykatës. Dhe gjykatësi  
5 të japë udhëzimet e veta në çfarëdo kohe.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kaufman. Keni diçka për  
7 t'iu përgjigjur?

8 Z. KAUFMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam  
9 asgjë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I kujtojë të gjitha palët  
11 që mund të ngrenë kundërshtime ndaj redaktimeve të bëra sipas  
12 urdhrit që kam dhënë unë, Urdhrit Kuadër Mbi Nxjerrjen e  
13 Informacionit.

14 I jap fjalën tani z. Laws, nëse ka diçka për të shtuar.

15 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit,  
16 që ma dhatë fjalën. Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E shikoj që ka kaluar një  
18 orë e gjysëm seancë.

19 Kështu që do të bëjmë një pushim të shkurtër për 20  
20 minuta dhe do të vijmë përsëri për të dhënë urdhrat  
21 përfundimtarë.

22 Seanca shtyhet.

23 --- Pauza fillon në orën 12.38

24 --- Seanca rifillon në orën 13.00

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani, do të nxjerrë dy

1 urdhra me gojë. I pari lidhet me nxjerrjen e vendimeve të mia  
2 lidhur me mocionet paraprahe.

3 Tani urdhëroj, që në përputhje me rregullën 9(5), afati  
4 kohor për dorëzimin e mocioneve paraprahe ndryshohet. Vendimet  
5 për mocionet paraprahe do të nxirren të premtën, 16 korrik.

6 Këtu përfundon urdhri i parë.

7 Pasi kam dëgjuar palët, do të nxjerrë një urdhër të dytë  
8 gojor, për parashtrime lidhur me vijimin e paraburgimit.

9 Urdhërojë, pra, ZPS-në të dorëzojë parashtrime për  
10 nevojën për vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli, z. Selimi  
11 dhe z. Krasniqi deri të premtën 28 maj dhe përgjigja përkatëse  
12 e ekipeve të Mbrojtjes në qoftë se dëshirojnë deri të hënën, 7  
13 qershor.

14 Këtu përfundon urdhri im i dytë me gojë dhe këtu  
15 përfundon edhe seanca e sotme, për të cilën falënderoj palët  
16 dhe pjesëmarrësit dhe si gjithmonë përkthyesit, stenografët,  
17 teknikët dhe personelin e sigurisë për praninë e tyre.

18 Seanca përfundon këtu.

19 --- Konferenca për ecurinë e çështjes përfundoi  
20 në orën 13.02

21

22

23

24

25